

MBI RAPORTIN E SPAK 2025

PROGRES DHE PROBLEMATIKA LIDHUR ME LLOGARIDHËNIEN E ZYRTARËVE TË ZGJEDHUR

Raport Analitik

Në kuadër të projektit “Promovimi i llogaridhënies së zyrtarëve të zgjedhur” mbështetur nga NED (National Endowment for Democracy). Pikëpamjet e shprehura në këtë material janë përgjegjësi e ISP-së.

Përmbledhje

Në kuadër të projektit “Promovimi i llogaridhënies së zyrtarëve të zgjedhur”, që Instituti i Studimeve Politike (ISP) po zbaton me mbështetjen e National Endowment for Democracy (NED), kjo analizë synon të ofrojë një vlerësim të përmbledhur dhe kritik të raportit vjetor 2025 të Strukturës së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar (SPAK), me fokus të veçantë në llogaridhënien e elitave politike dhe standardet europiane të ndjekjes penale.

Raporti vjetor 2025 i SPAK¹ konfirmon një zhvillim të rëndësishëm në sistemin e drejtësisë në Shqipëri: kalimin nga faza e ngritjes së institucioneve drejt prodhimit të rezultateve konkrete në luftën kundër korrupsionit, përfshirë hetimin dhe ndëshkimin e zyrtarëve të nivelit të lartë.

Ky progres ka krijuar një “*track record*” të dukshëm, duke e bërë llogaridhënien e elitave politike më të prekshme dhe të matshme. Ky zhvillim është në linjë edhe me mbështetjen e vazhdueshme të Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe partnerëve ndërkombëtarë për forcimin e shtetit të së drejtës dhe luftën kundër korrupsionit në Shqipëri, përfshirë rolin e

¹ *Struktura e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar (SPAK). (2026). Raporti vjetor 2025. Tiranë. Link: <https://kuvendiwebfiles.blob.core.windows.net/webfiles/202603091126097096Raport%20vjetor%202025%20SPAK.pdf>*

organizatave si National Endowment for Democracy (NED) në promovimin e transparencës dhe llogaridhënies.

Në vlerësimin e përgjithshëm sistemi ka progres, por nuk ka arritur ende standardin e konsoliduar të Bashkimit Europian, i cili kërkon hetime të qëndrueshme, të barabarta dhe të shoqëruara me ndikim real ekonomik dhe efekt parandalues. Në këtë kuptim, Shqipëria ka hyrë në fazën e rezultateve, por sfida kryesore mbetet transformimi i këtij progresi në një standard të qëndrueshëm europian, ku llogaridhënia e zyrtarëve të zgjedhur të jetë sistemike dhe pjesë integrale e funksionimit të shtetit të së drejtës. SPAK ka hyrë në një fazë ku llogaridhënia e elitave politike është bërë e prekshme dhe e matshme, duke kontribuar ndjeshëm edhe në rritjen e besimit publik ndaj institucioneve të drejtësisë. Kjo përfaqëson një zhvillim të rëndësishëm në raport me të kaluarën dhe një tregues pozitiv për funksionimin e reformës.

Megjithatë, ky progres mbetet ende në proces konsolidimi. Llogaridhënia nuk është plotësisht sistemike në të gjitha nivelet dhe sektorët, efekti ekonomik i ndëshkimit vijon të jetë i kufizuar në raport me sekuestrimet, ndërsa sfidat institucionale dhe procedurale vazhdojnë të ndikojnë në ritmin dhe qëndrueshmërinë e hetimeve.

Në këtë kuptim, sfida kryesore për Shqipërinë nuk është më krijimi i rasteve, por konsolidimi i një standardi të qëndrueshëm, të barabartë dhe të krahasueshëm me vendet e Bashkimit Europian, ku llogaridhënia e zyrtarëve të zgjedhur të jetë pjesë e natyrshme dhe e qëndrueshme e funksionimit të shtetit të së drejtës.

Gjetjet kryesore

- Rritje e hetimeve ndaj zyrtarëve të nivelit të lartë, me dërgim në gjykatë dhe vendime të formës së prerë, një zhvillim cilësor krahasuar me të shkuarën.
- Orientim drejt çështjeve më komplekse, që përfshijnë më shumë individë dhe struktura, përtej rasteve individuale.
- Rritje e hetimeve proaktive, duke forcuar autonominë e SPAK dhe duke reduktuar varësinë nga kallëzimet.
- Forcim i hetimeve financiare dhe rritje e sekuestrimeve, por me një hendek të dukshëm në konfiskimet përfundimtare.
- Rritje e besimit publik dhe e rolit të qytetarëve në nisjen e hetimeve.
- Krimet zgjedhore mbeten një dimension ende në zhvillim, pa një standard të qëndrueshëm ndëshkimi.

Rekomandime kryesore afatshkurtra (1–2 vite)

- Përshejtimi i procedurave për konfiskimin përfundimtar të pasurive dhe reduktimi i hendekut me sekuestrimet;
- Standardizimi i hetimeve financiare në çdo rast korrupsioni;
- Krijimi i mekanizmave të përshejtuar dhe të koordinuar për hetimin e krimeve zgjedhore;
- Rritja e transparencës për hetimet, statistikat dhe rezultatet gjyqësore ndaj zyrtarëve publikë;
- Forcimi i kapaciteteve njerëzore dhe teknike (hetues financiarë, analistë, ekspertë IT).

Rekomandime kryesore afatgjata (3–5 vite)

- Ndërtimi i një sistemi të integruar për rikuperimin dhe menaxhimin e pasurive kriminale;
- Konsolidimi i hetimeve proaktive dhe të bazuara në analizë risku (intelligence-led prosecution);
- Garantimi i një ndjekjeje penale të qëndrueshme, të barabartë dhe të paanshme ndaj elitave politike;
- Digjitalizimi i plotë i proceseve hetimore dhe integrimi i databazave shtetërore;
- Thellimi i bashkëpunimit ndërinstytucional dhe ndërkombëtar në përputhje me standardet e BE-së.

Vlerësim i përgjithshëm

Gjetjet e raportit konfirmojnë se Shqipëria ka kaluar nga faza e ngritjes së institucioneve të reja të drejtësisë në një fazë më të avancuar, ku llogaridhënia e zyrtarëve të zgjedhur dhe funksionarëve të lartë është bërë më e dukshme dhe e matshme. Rritja e hetimeve për korrupsion, përfshirja më e madhe e zyrtarëve të nivelit të lartë në proces penal dhe orientimi drejt çështjeve më komplekse tregojnë se SPAK ka filluar të ndërtojë një praktikë të qëndrueshme ndëshkuese. Në terminologjinë e Bashkimit Europian, ky zhvillim përfaqëson krijimin e një “*track record*” – një histori e verifikueshme rezultatesh në luftën kundër korrupsionit të nivelit të lartë.

Megjithatë, analiza e ISP vlerëson se ky progres, megjithëse i rëndësishëm, mbetet ende në fazën e konsolidimit. Standardet e BE-së kërkojnë që ndjekja penale të jetë jo vetëm e pranishme, por edhe sistemike, e barabartë dhe e parashikueshme në kohë. Në këtë drejtim,

raporti i SPAK reflekton një tranzicion të papërfunduar: nga prodhimi i rezultateve drejt ndërtimit të një standardi të qëndrueshëm institucional.

Zhvillimet pozitive përfshijnë rritjen e qasjes proaktive në hetime, ku SPAK po mbështetet gjithnjë e më shumë në analiza të brendshme dhe inteligjencë financiare, si dhe forcimin e hetimeve financiare dhe sekuestrimit të pasurive, në përputhje me parimin *“follow the money”*. Këto janë elemente thelbësore të praktikave europiane dhe tregojnë një orientim të qartë drejt modeleve më të avancuara të luftës kundër korrupsionit.

Megjithatë, disa kufizime strukturore mbeten evidente. Hendeku midis sekuestrimit dhe konfiskimit përfundimtar të pasurive kufizon efektin ekonomik të ndëshkimit, ndërsa trajtimi i krimeve zgjedhore mbetet ende i pa-standardizuar dhe pa një efekt të qëndrueshëm parandalues. Po ashtu, sfidat që lidhen me kapacitetet institucionale, ngarkesën e punës dhe nevojën për specializim më të thelluar tregojnë se sistemi është ende në proces maturimi.

Në këtë kuptim, përfundimi kryesor i analizës është se Shqipëria ka hyrë në një fazë të re të reformës në drejtësi, atë të rezultateve, por ende nuk ka arritur fazën e standardit të konsoliduar europian. Sfidat nuk qëndron më në ekzistencën e hetimeve ndaj zyrtarëve të lartë, por në garantimin që këto hetime të jenë të qëndrueshme, të barabarta dhe të shoqëruara me ndëshkim ekonomik real dhe efekt parandalues afatgjatë. Kalimi nga *“progres i dukshëm”* në *“standard i BE-së”* kërkon pikërisht këtë transformim.

Llogaridhënia e zyrtarëve të nivelit të lartë: nga përjashtim në trend

Një nga treguesit më domethënës të raportit është rritja e aktivitetit hetimor dhe gjyqësor ndaj zyrtarëve të nivelit të lartë. Gjatë vitit 2025, SPAK ka pasur në hetim dhjetëra zyrtarë dhe ish-zyrtarë, ndërkohë që mbi gjysma e tyre janë dërguar për gjykim dhe një pjesë janë dënuar me vendime të formës së prerë. Ky zhvillim përfaqëson një ndryshim cilësor në raport me të shkuarën, ku përgjegjësia penale e elitave politike ishte sporadike dhe shpesh e munguar. Sot, të dhënat sugjerojnë se ndjekja penale e nivelit të lartë po bëhet pjesë e normalitetit institucional, edhe pse ende jo në përmasa plotësisht sistemike.

Në këtë kontekst, SPAK ka filluar të ndërtojë atë që partnerët ndërkombëtarë e cilësojnë si një *“rekord të qëndrueshëm”* në luftën kundër korrupsionit të nivelit të lartë, duke forcuar perceptimin se askush nuk është mbi ligjin. Ky është një hap thelbësor për standardet e BE-së, të cilat kërkojnë jo vetëm raste individuale, por një praktikë të vazhdueshme dhe të besueshme ndëshkueshmërie në nivelet më të larta të vendimmarrjes.

Një tjetër element i rëndësishëm është ndryshimi në natyrën e hetimeve. Edhe pse numri i çështjeve të dërguara në gjykatë ka pësuar një rënie relative, numri i personave të përfshirë në to është rritur, duke treguar se SPAK po fokusohet në çështje më komplekse, me më shumë

aktorë dhe me dimension më të gjerë organizativ . Ky orientim sinjalizon një kalim nga hetimet ndaj individëve të izoluar drejt:

- goditjes së rrjeteve të korrupsionit,
- analizës së skemave të organizuara,
- dhe ndjekjes së zinxhirit të përgjegjësive.

Në terma të llogaridhënies, ky është një zhvillim kritik, pasi vetëm hetimet strukturore mund të prodhojnë efekt afatgjatë në integritetin e sistemit politik dhe administrativ, duke reduktuar hapësirat për riciklim të praktikave korruptive.

Një tregues tjetër me rëndësi është rritja e hetimeve të nisura kryesisht nga vetë SPAK, të cilat përbëjnë një pjesë të konsiderueshme të procedimeve të reja . Ky fakt tregon se institucioni nuk është më vetëm një receptor i kallëzimeve, por një aktor proaktiv që identifikon dhe ndjek vetë rastet me interes publik. Kjo qasje përputhet me praktikën më të avancuar europiane, ku institucionet e ndjekjes penale mbështeten në analiza të riskut dhe inteligjencë kriminale, dhe jo vetëm në inpute të jashtme.

Në të njëjtën kohë, rritja e hetimeve të nisura nga kallëzimet e qytetarëve tregon një nivel të lartë besimi publik dhe një rol në rritje të shoqërisë në mekanizmat e llogaridhënies . Ky është një indikator pozitiv për qëndrueshmërinë e reformës, pasi lidh drejtpërdrejt performancën institucionale me aktivizimin qytetar.

Megjithatë, pavarësisht këtij progresi, mbeten disa kufizime që pengojnë kalimin drejt standardit të plotë europian. Ndjekja penale e zyrtarëve të nivelit të lartë nuk është ende plotësisht e shtrirë në mënyrë sistematike në të gjitha nivelet dhe sektorët, ndërsa ndikimi ekonomik i hetimeve mbetet i kufizuar për shkak të nivelit të ulët të konfiskimeve përfundimtare. Po ashtu, mungesa e një praktike të standardizuar dhe të qëndrueshme në fusha të ndjeshme si krimet zgjedhore tregon se llogaridhënia ende nuk ka arritur të prodhojë një efekt të plotë parandalues.

Në tërësi, të dhënat e vitit 2025 tregojnë se Shqipëria ka kaluar nga faza e përjashtimit drejt një trendi të qëndrueshëm të hetimit të elitave, por për të arritur standardet e BE-së kërkohet që ky trend të konsolidohet në një sistem të barabartë, të parashikueshëm dhe të qëndrueshëm në kohë.

Krimet zgjedhore: një dimension ende në zhvillim

Megjithëse raporti i SPAK nuk i trajton krimet zgjedhore si një kapitull dominues më vete, të dhënat dhe praktika institucionale tregojnë se ky dimension mbetet një nga testet më të rëndësishme për llogaridhënien reale të zyrtarëve të zgjedhur dhe për cilësinë e demokracisë

në Shqipëri. Në standardet europiane dhe në vlerësimet e vazhdueshme të OSBE/ODIHR, integriteti i procesit zgjedhor lidhet drejtpërdrejt me aftësinë e shtetit për të hetuar dhe ndëshkuar në kohë reale shkeljet që lidhen me zgjedhjet.

Në këtë kuadër, hetimet që lidhen me:

- abuzimin me funksionin publik gjatë fushatave,
- përdorimin e burimeve shtetërore për qëllime elektorale,
- presionin mbi votuesit apo administratën publike,
- dhe ndikimin e paligjshëm në procesin zgjedhor,

janë thelbësore për të garantuar barazinë në garë dhe besimin e qytetarëve në zgjedhje. Këto forma shkeljesh, për shkak të natyrës së tyre, lidhen drejtpërdrejt me zyrtarët në detyrë dhe për këtë arsye përbëjnë një indikator kyç të llogaridhënies politike dhe penale.

Raporti i vitit 2025 sugjeron një rritje të vëmendjes institucionale ndaj këtyre fenomeneve dhe një ndërgjegjësim më të madh për rëndësinë e ndjekjes penale në këtë fushë. Megjithatë, krahasuar me praktikën e vendeve të BE-së, ky dimension mbetet ende në zhvillim dhe nuk ka arritur të konsolidohet si një politikë e qëndrueshme hetimore dhe ndëshkuese.

Sfida kryesore lidhet me faktin se krimet zgjedhore kanë një natyrë të veçantë:

- ato janë të përqendruara në periudha të shkurtra kohore,
- kërkojnë reagim të menjëhershëm dhe koordinim ndër-institucional,
- dhe ndikojnë drejtpërdrejt në legjitimitetin e institucioneve të dala nga zgjedhjet.

Në mungesë të një reagimi të shpejtë dhe të dukshëm, efekti ndëshkues zbehet dhe perceptimi i pandëshkueshmërisë mbetet i lartë.

Një problem tjetër lidhet me mungesën e një praktike të standardizuar dhe të parashikueshme. Ndërsa në vendet e BE-së ekzistojnë mekanizma të konsoliduar për hetimin e krimeve zgjedhore, përfshirë struktura të posaçme, procedura të përshpejtuara dhe koordinim të fortë me autoritetet zgjedhore ndërsa në Shqipëri këto elemente janë ende në fazë zhvillimi. Si rezultat, ndërhyrjet shpesh mbeten episodike dhe të varura nga konteksti politik apo presioni publik.

Po ashtu, mungesa e një lidhjeje të qartë midis hetimeve për krime zgjedhore dhe ndëshkimit përfundimtar kufizon efektin parandalues. Në standardet europiane, qëllimi nuk është vetëm ndëshkimi pas faktit, por krijimi i një klime ku aktorët politikë dekurajohen nga shkeljet për shkak të rrezikut real dhe të menjëhershëm të përgjegjësisë penale.

Në këtë drejtim, Shqipëria ka bërë hapa përpara në drejtim të rritjes së ndërhyrjes institucionale, por mbetet e nevojshme ndërtimi i një qasjeje më të strukturuar dhe të qëndrueshme. Kjo nënkupton:

- trajtimin e krimeve zgjedhore si prioritet strategjik,
- krijimin e mekanizmave të përshpejtuar hetimorë gjatë periudhave zgjedhore,
- dhe sigurimin e transparencës mbi rezultatet e hetimeve dhe vendimeve gjyqësore.

Në përfundim, krimet zgjedhore mbeten një nga hallkat më të dobëta në zinxhirin e llogaridhënies në Shqipëri. Ndërsa progresi është i dukshëm në nivelin e vëmendjes dhe ndërhyrjes, sfida reale mbetet ndërtimi i një praktike të qëndrueshme ndëshkuese dhe krijimi i një efekti parandalues të besueshëm për zgjedhjet e ardhshme. Vetëm në këtë mënyrë mund të garantohet që llogaridhënia e zyrtarëve të zgjedhur të shtrihet jo vetëm në ushtrimin e detyrës, por edhe në mënyrën se si ata konkurrojnë dhe fitojnë pushtetin.

SPAK 2025: nga prodhimi i rezultateve te sfida e konsolidimit të llogaridhënies

Raporti vjetor 2025 i Strukturës së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar (SPAK) konfirmon se Shqipëria ka hyrë në një fazë të re të reformës në drejtësi: atë të prodhimit të rezultateve konkrete në llogaridhënie, veçanërisht ndaj zyrtarëve të zgjedhur dhe funksionarëve të nivelit të lartë. Në dallim nga vitet e para të funksionimit, ku fokusi ishte ngritja e kapaciteteve dhe krijimi i besimit publik, të dhënat e vitit 2025 tregojnë një zhvendosje të qartë drejt ndëshkueshmërisë reale dhe konsolidimit të praktikës hetimore.

Ky progres reflektohet në disa drejtime kyçe. Rritja e hetimeve dhe procedimeve ndaj zyrtarëve të nivelit të lartë tregon se llogaridhënia e elitave politike po kalon nga përjashtim në trend, duke ndërtuar gradualisht një praktikë më të qëndrueshme ndëshkuese. Paralelisht, orientimi drejt çështjeve më komplekse, me më shumë aktorë dhe dimension organizativ, sinjalizon një kalim të rëndësishëm nga hetimet individuale drejt goditjes së rrjeteve të korrupsionit dhe zinxhirit të përgjegjësive. Kjo përfaqëson një qasje më të avancuar, në përputhje me praktikatat europiane të ndjekjes penale.

Një element tjetër domethënës është rritja e hetimeve të nisura nga vetë SPAK, që reflekton një transformim nga një institucion reaktiv në një aktor proaktiv, i aftë të identifikojë dhe ndjekë vetë rastet me interes publik. Kjo rrit ndjeshëm potencialin për llogaridhënie reale, pasi redukton varësinë nga kallëzimet politike apo institucionale dhe forcon autonominë hetimore.

Megjithatë, raporti evidenton edhe kufizime që pengojnë kalimin drejt standardit të konsoliduar europian. Një nga sfidat kryesore mbetet dimensionin financiar i luftës kundër korrupsionit. Rritja e vlerës së pasurive të sekuestruara tregon progres në hetimet financiare dhe në ndjekjen e aseteve kriminale, por diferenca e madhe me konfiskimet përfundimtare dëshmon për procese të gjata dhe komplekse gjyqësore. Në mungesë të një konfiskimi efektiv,

ndëshkimi ekonomik mbetet i pjesshëm dhe efekti parandalues i luftës kundër korrupsionit reduktohet ndjeshëm.

Në këtë kuadër të përgjithshëm të llogaridhënies, krimet zgjedhore mbeten një dimension ende në zhvillim dhe një nga testet më të rëndësishme për funksionimin e shtetit të së drejtës. Ndërsa ka një rritje të vëmendjes institucionale ndaj rasteve që lidhen me abuzimin me funksionin publik gjatë fushatave, përdorimin e burimeve shtetërore dhe ndikimin e paligjshëm në procesin zgjedhor, kjo fushë nuk ka arritur ende të konsolidohet si një praktikë e qëndrueshme dhe e parashikueshme ndëshkimi. Natyra e tyre e përqendruar në kohë, nevoja për reagim të menjëhershëm dhe kërkesa për koordinim ndërinstytucional e bëjnë këtë kategori veçanërisht sfiduese. Në mungesë të një reagimi të shpejtë dhe të dukshëm, efekti ndëshkues zbehet dhe rreziku i perceptimit të pandëshkueshmërisë mbetet i lartë. Për këtë arsye, krimet zgjedhore përfaqësojnë një nga hallkat më të dobëta të zinxhirit të llogaridhënies dhe kërkojnë një qasje më të strukturuar, të standardizuar dhe me efekt real parandalues.

Një zhvillim pozitiv që përforcon qëndrueshmërinë e reformës është niveli i lartë i besimit publik dhe roli aktiv i qytetarëve në nisjen e hetimeve. Një pjesë e konsiderueshme e procedimeve ka ardhur nga kallëzime të qytetarëve, duke dëshmuar një lidhje të drejtpërdrejtë midis besimit në institucion dhe gatishmërisë për të denoncuar korrupsionin. Ky është një indikator i rëndësishëm për funksionimin afatgjatë të sistemit, pasi llogaridhënia nuk mbështetet vetëm në institucione, por edhe në aktivizimin e shoqërisë.

Në përfundim, raporti i SPAK 2025 konfirmon një fazë të re të reformës në drejtësi: atë të rezultateve. Megjithatë, sfida kryesore mbetet transformimi i këtij progresi në një standard të qëndrueshëm dhe të krahasueshëm me vendet e Bashkimit Europian, ku llogaridhënia e zyrtarëve të zgjedhur është sistemike, e barabartë dhe e shoqëruar me ndikim real ekonomik dhe parandalues.

Sfidat: presioni politik, dekriminalizimi, kapacitetet dhe kuadri ligjor

Pavarësisht progresit të dukshëm, raporti i SPAK 2025 evidenton një sërë sfidash strukturore që ndikojnë drejtpërdrejt në ritmin, cilësinë dhe qëndrueshmërinë e llogaridhënies ndaj zyrtarëve të zgjedhur dhe elitave publike. Këto sfida lidhen si me faktorë të jashtëm, si presioni politik dhe konteksti institucional, ashtu edhe me kufizime të brendshme në kapacitete dhe kuadrin ligjor.

Një nga elementët më të ndjeshëm mbetet presioni politik dhe publik ndaj hetimeve të nivelit të lartë. Duke qenë se SPAK operon në një mjedis politik të polarizuar, hetimet ndaj zyrtarëve të zgjedhur shpesh shoqërohen me reagime politike, narrativa delegjitimimi apo përpjekje për ndikim indirekt. Edhe pse këto nuk përkthehen domosdoshmërisht në ndërhyrje të drejtpërdrejta, ato krijojnë një klimë presioni që mund të ndikojë në perceptimin publik dhe

në besimin ndaj procesit. Në standardet e BE-së, ruajtja e pavarësisë funksionale dhe mbrojtja nga presioni politik janë elementë thelbësorë për garantimin e një sistemi të besueshëm të drejtësisë.

Në planin institucional, mungesa e burimeve njerëzore dhe ngarkesa e lartë e punës përbëjnë një sfidë të vazhdueshme. Rritja e numrit dhe kompleksitetit të çështjeve ka tejkaluar kapacitetet ekzistuese, duke krijuar presion mbi prokurorët, hetuesit dhe stafin mbështetës. Në veçanti, hetimet financiare dhe ato që lidhen me rrjete të organizuara kërkojnë ekspertizë të specializuar dhe kohë të konsiderueshme. Në mungesë të një zgjerimi të kapaciteteve dhe specializimit të mëtejshëm, ekziston rreziku që cilësia dhe shpejtësia e hetimeve të komprometohet.

Së fundi, raporti nënvizon nevojën për përmirësime në kuadrin ligjor dhe kompetencat procedurale. Ndërkohë që baza ligjore e reformës në drejtësi ka krijuar instrumente të rëndësishme për hetimin e korrupsionit dhe krimin të organizuar, praktika ka evidentuar boshllëqe dhe nevoja për përshtatje të mëtejshme, veçanërisht në drejtim të hetimeve financiare, konfiskimit të pasurive dhe procedurave të përshpejtuara në raste me interes publik. Harmonizimi i mëtejshëm me standardet e BE-së kërkon një kuadër më fleksibël, efikas dhe të orientuar drejt rezultateve.

Në tërësi, këto sfida tregojnë se ndërsa Shqipëria ka arritur një nivel të ri në prodhimin e rezultateve në luftën kundër korrupsionit, konsolidimi i plotë i llogaridhënies kërkon adresimin paralel të faktorëve politikë, institucionalë dhe ligjorë. Vetëm në këtë mënyrë mund të sigurohet që progresi i arritur të shndërrohet në një standard të qëndrueshëm dhe të pakthyeshëm.

Përtej SPAK? Një test për politikën dhe institucionet

Në debatin publik shqiptar, shpesh llogaridhënia reduktohet te performanca e SPAK. Ky është një keqkuptim i rrezikshëm. SPAK mund të hetojë dhe të ndjekë penalisht, por nuk mund të garantojë i vetëm standardin e shtetit të së drejtës. Ky standard varet nga mënyra se si sillet politika, si funksionon parlamenti, si informon media dhe sa konsekuent është presioni ndërkombëtar.

Parlamenti mbetet hallka më problematike dhe njëkohësisht më vendimtare. Ai ka në dorë mjetet për të përmirësuar kuadrin ligjor, veçanërisht për konfiskimin e pasurive dhe hetimet financiare, por shpesh reagon me vonesë ose në mënyrë selektive. Në vend që të ndërtojë rregulla të qëndrueshme, politika shpesh prodhon ndërhyrje të fragmentuara dhe të kushtëzuara nga interesat e momentit. Nëse parlamenti nuk e trajton luftën kundër korrupsionit si prioritet institucional dhe jo si instrument politik, hendeku midis progresit dhe standardit do të mbetet i hapur.

Klasa politike, në tërësi, përballet me një provë më të thellë: a e pranon realisht llogaridhënien, apo vetëm e toleron atë kur i shërben? Retorika delegitimues ndaj institucioneve të drejtësisë, sulmet selektive dhe standardet e dyfishta ndaj hetimeve e minojnë drejtpërdrejt besimin publik. Në të njëjtën kohë, mungesa e filtrave realë për kandidatët dhe tolerimi i praktikave të njohura, nga përdorimi i burimeve shtetërore deri te ndikimi në procese zgjedhore, tregojnë se problemi nuk është vetëm penal, por thellësisht politik.

Media ka një rol po aq kritik. Në një mjedis të polarizuar, ajo lëviz shpesh mes dy ekstremeve: ose amplifikon narrativat politike, ose trajton çështjet penale si spektakël. Ajo që mungon ende në mënyrë të qëndrueshme është gazetaria investigative e bazuar në fakte dhe analiza të thelluara që ndihmojnë publikun të kuptojë kompleksitetin e korrupsionit dhe të proceseve gjyqësore. Pa këtë dimension, transparenca mbetet sipërfaqësore dhe lehtësisht e manipulueshme.

Faktori ndërkombëtar ka qenë dhe mbetet një nga garantët kryesorë të reformës në drejtësi. Megjithatë, sfida tashmë nuk është vetëm mbështetja teknike, por vendosja e standardeve më të qarta dhe më të matshme për rezultatet. Shqipëria nuk ka më nevojë vetëm për asistencë, por për një proces më të fortë vlerësimi dhe presioni pozitiv, që të lidhë progresin me standardet konkrete të BE-së.

Në fund, pyetja thelbësore nuk është më nëse SPAK po funksionon, por nëse sistemi politik dhe institucional është gati të jetojë me pasojat e funksionimit të tij. Sepse llogaridhënia reale nuk matet vetëm me hetime dhe vendime gjyqësore, por me ndryshimin e sjelljes së politikës. Dhe pikërisht këtu, testi i vërtetë për Shqipërinë sapo ka filluar.